

UDHËZIM
Nr.1, datë 14.12.2004

**PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË TARIFËS PËR DHËNIEN E LEJES SË
PËRPUNIMIT INDUSTRIAL DHE/OSE PRODHIMIT TË PRODUKTEVE TË DUHANIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 14 të ligjit nr.8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve” dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.126, datë 27.2.2003 “Për kriteret e dhënies së lejes së përpunimit industrial dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit”, Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

I. Me përpunim industrial të duhanit kuptojmë procesin e përpunimit të duhanit gjeth si produkt të gatshëm për industrinë e prodhimit të produkteve të duhanit. Procesi i përpunimit industrial të duhanit përfshin:

- Klasifikimin e duhaneve të grumbulluara nga fermeri;
- Manipulimin e duhaneve në tonga;
- Ambalazhimin dhe etiketimin e tongave;
- Fermentimin e duhaneve.

II. Pas përfundimit të këtij procesi, duhanet e përpunuara janë të gatshme për t’u përdorur për prodhimin e produkteve të duhanit, që janë: cigaret, puretat, purot, duhanet për llullë, duhani kaush, burnoti dhe duhani për përtypje.

III. Personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, që kryejnë ose kërkojnë të kryejnë përpunimin industrial të duhanit dhe/ose prodhimin e produkteve të tij, duhet të bëjnë kërkesë me shkrim pranë Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve për t’u pajisur me leje të përpunimit industrial dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit. Leja është e vlefshme për 10 vjet dhe pajisja me leje bëhet pasi të shlyhet tarifa përkatëse.

IV. Kriteret për caktimin e tarifës për dhënie e lejes së përpunimit industrial të duhanit janë:

1. Kapaciteti grumbullues dhe përpunues i duhaneve;
2. Niveli teknologjik i instaluar dhe i shfrytëzuar:

- I mekanizuar quhet procesi ku i gjithë përpunimi, që nga shfletosja dhe klasifikimi e deri te manipulimi, realizohet nëpërmjet mjeteve të mekanizuara, si: transportierë, sistemi pneumatik, harmonizues dhe sitë vibruese për realizimin e shfletosjes, si dhe sistemit të presimit për manipulimin e duhaneve në tonga.

- Gjysmë i mekanizuar është procesi i kombinuar me dorë dhe me mjete të mekanizuara, ku me dorë kryhet shfletosja dhe deklasifikimi i duhaneve, kurse manipulimi i duhaneve në tonga kryhet nëpërmjet sistemit të mekanizuar të presimit.

a) Për subjektet që kanë nivel teknologjik të mekanizuar dhe kapacitet grumbullues dhe përpunues të duhaneve:

- | | |
|--------------------------------------|---------------|
| - deri në 1000 ton/vit, tarifa është | 290 000 lekë |
| - deri në 2000 ton/vit, tarifa është | 350 000 lekë |
| - mbi 2000 ton në vit, tarifa është | 410 000 lekë. |

b) Për subjektet që kanë nivel teknologjik gjysmë të mekanizuar dhe kapacitet grumbullues dhe përpunues të duhaneve:

- | | |
|--------------------------------------|---------------|
| - deri në 1000 ton/vit, tarifa është | 230 000 lekë |
| - deri në 2000 ton/vit, tarifa është | 290 000 lekë |
| - mbi 2000 ton në vit, tarifa është | 350 000 lekë. |

V. Kriteret për caktimin e tarifës për dhënie e lejes së prodhimit të produkteve të duhanit janë:

1. Kapaciteti prodhues i produkteve të duhanit;
2. Teknologjia e prodhimit e instaluar:

- Proces i plotë i prodhimit, ku përfshihen proceset e harmonizimit, konfeksionimit, ambalazhimit.

- Procese të konfeksionim-ambalazhimit.

a) Për subjektet që kanë proces të plotë prodhimi dhe kapacitet prodhues të produkteve të duhanit:

- deri në 300 ton produkte duhani në vit, tarifa është 350 000 lekë

- deri në 600 ton produkte duhani në vit, tarifa është 410 000 lekë

- mbi 600 ton produkte duhani në vit, tarifa është 460 000 lekë.

b) Për subjektet që kanë procese të konfeksionim-ambalazhimit me kapacitet prodhues të produkteve të duhanit:

- deri në 300 ton produkte duhani në vit, tarifa është 240 000 lekë

- deri në 600 ton produkte duhani në vit, tarifa është 300 000 lekë

- mbi 600 ton produkte duhani në vit, tarifa është 350 000 lekë.

VI. Sipas përcaktimit të bërë nga komisioni i ekspertëve, subjektet do të shlyejnë tarifën e përcaktuar në pikat IV.a, IV.b dhe V.a, V.b të këtij udhëzimi.

VII. Administrimi i të ardhurave të krijuara nga veprimtaria për dhënien e lejes së përpunimit industrial dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.424, datë 9.7.1998 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.

VIII. Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi është edhe tabela bashkëlidhur mbi përcaktimin e tarifave.

IX. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE I USHQIMIT
Agron Duka

**PËRCAKTIMI I PAGESAVE TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT DHE TARIFAVE PËR
DHËNIEN E LEJES SË PËRPUNIMIT INDUSTRIAL DHE/OSE PRODHIMIT TË PRODUKTEVE
TË DUHANIT**

Nr.	Emërtimi	600	602			Kosto	Fitimi 10%	Tarifa
		Paga	Dieta	Shp.transp	Shp.Përgj			
I.	Kriteret për caktimin e tarifës për dhënie e lejes së përpunimit industrial të duhanit janë:							
I.a	Për subjektet që kanë nivel teknologjik të mekanizuar dhe kapacitet grumbullues dhe përpunues të duhaneve							
	Deri 1000 ton/vit	110 000	100 000	10 000	44 000	264 000	26 400	290 000
	Deri 2000 ton/vit	132 000	120 000	12 000	52 800	316 800	31 680	350 000
	Mbi 2000 ton/vit	154 000	140 000	14 000	61 600	369 600	36 960	410 000
I.b	Për subjektet që kanë nivel teknologjik gjysëm të mekanizuar dhe kapacitet grumbullues dhe përpunues të duhaneve							
	Deri 1000 ton/vit	88 000	80 000	8000	35 200	211 200	21 120	230 000
	Deri 2000 ton/vit	110 000	100 000	10 000	44 000	264 000	26 400	290 000
	Mbi 2000 ton/vit	132 000	120 000	12 000	52 800	316 800	31 680	350 000
II.	Kriteret për caktimin e tarifës për dhënie e lejes së prodhimit të produkteve të duhanit janë:							
II.a	Për subjektet që kanë proces të plotë prodhimi dhe kapacitet prodhues të produkteve të duhanit:							
	Deri 300 ton/vit	132 000	120 000	12 000	52 800	316 800	31 680	350 000
	Deri 600 ton/vit	154 000	140 000	14 000	61 600	369 600	36 960	410 000
	Mbi 600 ton/vit	176 000	160 000	16 000	70 400	422 400	42 240	460 000
II.b	Për subjektet që kanë procese të konfeksionim-ambalazhimit me kapacitet prodhues të produkteve të duhanit:							
	Deri 300 ton/vit	88 000	80 000	8000	35 200	211 200	21 120	240 000
	Deri 600 ton/vit	110 000	100 000	10 000	44 000	264 000	26 400	300 000
	Mbi 600 ton/vit	132 000	120 000	12 000	52 800	316 800	31 680	350 000